



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2023:176235

Datë: 01.02.2024

Numri i dokumentit: 05272277

C.nr.812/23

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, me gjyqtaren, Pajtesë Boshnjaku në çështjen juridiko civile kontestimore të paditësit Z.R nga fshati C., Komuna I., përfaqësuar nga Ramadan Shatri, avokat nga Istogu kundër të paditures Firma “M. C.”, SH.P.K., me seli në Rrugën “F.Ferati”, përfaqësuar nga I.R dhe F.R, nga baza juridike vërtetim pronësisë, vlera e kontestit 1,000.00 euro, duke vendosur lidhur me marrëveshjen për ndërmjetësim të datës, 25.12.2023, jashtë seancës, me datë, 01.02.2024 bie këtë:

A K T V E N D I M

ANULOHET - Marrëveshja e Ndërmjetësimit e arritur në mes të paditësit A.B nga, komuna Istog, dhe të paditures Firma “M.C”, SH.P.K., me seli në Rrugën “F.Ferati”, përfaqësuar nga I.R dhe F.R, nga baza juridike vërtetimit i të drejtës së pronësisë, me numër të Referencës së Ndërmjetësimit Nd.508/23, të datës, 15.12.2023.

A r s y e t i m

Paditësi me datë, 16.08.2023 ka ushtruar padi kundër të paditures me bazë juridike vërtetim i të drejtës së pronësisë.

Gjykata, rastin e ka referuar tek referenti i ndërmjetësimit, pas kërkesës së paditësit përmes të autorizuarit me parashtrësën e datës 09.11.2023.

Me marrëveshjen për zgjidhjen e ndërmjetësimit që mbanë shenjën Nd.408/23, të datës, 15.12.2023, paditësi dhe i padituri përmes të autorizuarve kanë arritur marrëveshjen për

zgjidhjen e kontestit me marrëveshjen në procedurën e ndërmjetësimit, marrëveshja është nënshkruar nga i autorizuari i paditësit dhe përfaqësuesi i të paditurës me datën 15.12.2023.

Në nenin, 17, par. 5 i Ligji për Ndërmjetësimin është përcaktuar se: *“Gjykata ose prokuroria mund ta anuloj marrëveshjen e arritur me ndërmjetësim, kur konstaton se është lidhur në kundërshtim me ligjin në fuqi dhe kur nuk pasqyrohet vullneti i palëve në ndërmjetësim”*.

Pas vlerësimit të kësaj marrëveshje të arritur në procedurën e ndërmjetësimit, gjykata gjenë se e njëjta nuk ka mbështetje ligjore dhe atë konkretisht me nenin 3.3 të LPK-së, pasi që palët me asnjë provë nuk e kanë dëshmuar faktin se e paditura mund të disponoj lirshëm me objektin kontestues, për t’ia pohuar kërkesëpadinë këtu paditësit përfaqësuesi i së njëjtës, ngase me asnjë provë nuk është dëshmuar se paditura është pronare e kësaj banese, objekt kontesti, për çka gjykata gjen se paraqitet i nevojshëm trajtimi i kësaj çështje me caktimin e shqyrtim gjyqësor. Nga arsyet e lartcekura e në kuptim të dispozitë ligjor nga nenin 17.5, të Ligji për Ndërmjetësimin, si dhe nenin, 142.1 dhe 2 e lidhur me nenin 173 të LPK- së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË-DEGA NË ISTOG
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
C.nr.812/2023, datë 02.01.2024

Gjyqtarja
Pajtesë Boshnjaku

Udhëzimi juridik :

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes të kësaj gjykate.